



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**C.nr.107/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari individual Naim Mehulli, ne çështjen juridike te paditësit **V.B** nga .... Rr. “....” p.n, .... te cilin e përfaqëson N.B jurist ..... Rr. “.....” p.n, Komuna e ....., kundër te paditurës Komuna e ....., për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin te pagave përcjellëse për ne pension pas mbajtjes se seancës kryesore me dt.17.01.2019 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESERISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit V.B nga f.sh .... Rr. “.....” p.n, Komuna e ..... dhe

**II.OBLIGOHET** e paditura Komuna e ..... t’ia paguajë paditësit V.B, ne emër te pagesës për shpërblim jubilar pas pensionimit si mësimdhënës te e paditura për 42 vjet te provojës se punës ne vlerë te 150% te një page bazë, shumen prej **764,44 euro**, dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension, shumen prej **1.528,89 euro**, respektivisht shuma totale prej **2.293,33 euro (dy mije e dyqind e nëntëdhjetë e tre euro, e tredhjet e tre cent)**, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**III.OBLIGOHET** e paditura Komuna e .... t’ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej **40 euro**, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**IV.REFUZOHET E PA BAZUAR** pjesa e kërkesëpadiisë së paditëses V.B nga f.sh .... i.... Rr. “....” p.n, Komuna e ....., për kompensimin e një page e gjysmë për shpërblim jubilar ne shumën prej 764,44 euro.

**A r s y e t i m**

Paditësi me datën 22.02.2018 ka ushtruar padi kundër te paditurës për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave për shpërblimin jubilar ne shumën e përgjithshme prej 3,031.20euro.

Gjykata, me dt. 15.01.2019, ka caktuar seancë për shqyrtim përgatitore, ne te cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit, dhe i autorizuari i te paditurës.

I autorizuari i paditësit në seancë deklaroi se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të ushtruar me shkrim me propozim që e njëjta të aprovohet si e themeltë. Paditësi gjatë vitit 1974 ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën fillimisht në Shkollën fillore "....." në ..... Komuna e ....., si mësimdhënëse të ciklit të ulte mësues klasor deri në shtator të vitit 1977 me pastaj nga muaji shtator 1978 në paralele të Shkollës fillore "....." në fshatin ..... e cila me vone quhet Shkolla "....." paditësi kishte punuar në këtë Shkollë deri në vitin 1992 ndërsa nga muaji tetor i vitit 1992 kalon në Shkollën fillore "....." në fsh..... të cilit ia vënë emirin ".....i" dhe ka punuar deri me rastin dalje në pension, respektivisht në vitin 2018 për të dëshmuar paditësi gjykatës i'a ka dorëzuar edhe prova materiale të pa kontestueshme të cilat gjenden në shkresat e lendes, sa i përket shumës të saktë të cili paditësi i kishte marruar gjatë tre muajve të fundit paditësi ofron si dëshmi listat e pagave nga ku mund të konstatohet se në emër të pagës ka pranuar shumën financiare në vlerë prej 509.603 euro, meqenëse është një dallim prej kërkesëpadisë së precizuar në aktgjykim bej edhe precizimin e kërkesëpadisë ashtu që shuma e përgjithshme duhet të obligohet e paditura është shuma 3057.78 euro, po ashtu i kërkojmë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të taksës për padi shumën prej 40 euro, ndërsa sa i përket kamatës heqim dorë nga e njëjta. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsideroi se nga provat e prezantuara pranë gjykatës në mënyrë të pa kontestueshme u vërtetua themelsia e padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit, të drejtën e paditësit për të drejtë të pagave për pension e garanton ligji dhe aktet tjera nënligjore sikurse që është precizuar në seancën e sotme, andaj duke u bazuar në ligjin e aplikueshëm, provat materiale mbi të cilat mbështetet padia, argumentet dhe thëniet e padisë i propozojmë gjykatës që të aprovi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar.

I autorizuari i të paditurës në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë por në asnjë moment duke mos e mohuar kontributin e paditësit në mësimdhënie në të mirën e qytetarëve të ....., mirëpo realisht mungesa e mjeteve financiare në buxhetin e Komunes i ka bërë të pamundur pagesat financiare. Kundërshtimi i jone ndërlihet kryesisht të pagat jubilarë ku në i propozojmë gjykatës që për bazë në aktgjykimin që do ta sjellë ta ketë kontratën kolektive sektoriale që ka hyrë në fuqi më dt. 18.04.2017. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Gjykata, në procedurën e leximit të provave, referuar nenit 7 dhe 8, lexoi: vendimi për pushimin e marrëdhënies së punës nr. ....i datës 04.01.2018, njoftimi- përgjigjja e dhënë nga e paditura I dt. ....., kontrata e punës në mes të paditësit dhe të paditurës e dt. 08.09.2015, marrëveshja e përgjithshme kolektive e dt. 18.03.2014, librezat e punës për paditësin me numër të regjistrimit 26954, vërtetimi lëshuar nga SHFMU "....." ..... i dt. ....., vendimi lëshuar nga e paditura nga data ....., kontrata kolektive të arsimit në Kosovë e dt. 18.04.2017, vërtetimi lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale

e dt. 16.01.2018, vërtetimi për provojnë e punës e dt....., pasqyra e llogaris bankare për paditësin për katër muajt e fundit para se paditësi të del në pension.

Nuk është kontestues fakti që paditësi ka qene në marrëdhënie pune të e paditura si mësimdhënës për më tepër se 40 vite, ky fakt u vërtetua nga librezat e punës nr....., vërtetimi lëshuar nga SHFMU “.....” ..... nr.3/2018 dt..... dhe vërtetimi për provojnë e punës lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dt.16.01.2018.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 509.63 euro, ku kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2017.

Nuk është kontestues se paditësit i ka pushuar marrëdhëniet e punës për shkak të plotësimit të kushteve për pension të pleqërisë, e kjo vërtetohet nga vendimi nr. ...., i dt. ....

Nuk është kontestuese se paditësi ka paraqit kërkesë tek e paditura sa i parkete realizimit të kësaj kërkesë lëndore, kjo vërtetohet në baze të kërkesës së paditëses, e të cilën kërkesë e paditura e ka pranuar me dt.17.01.2018, e për të cilin kërkesë në bazë të shkresave të lendes e paditura me date ..... i është përgjigjur dhe e ka njoftuar të njëjtën se DKA nuk gjeti baze ligjore që tu bëhet një pagës e tillë.

Gjykata, lidhur me bazën e kërkesës padisë, iu referua nenit 35 par. 8 nën par 8.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 e cila parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar për 40 vjet të përvojës në vlerë të 150% të një page bazë” dhe nenit 35.9 të po të njëjtës kontratë i cili parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u referua në vlerën e tri pagave të fundit të paditësit e cila vërtetohet nga gjendja e llogarisë për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2017, se paditësi ka marrë tri pagat e fundit në vlerë prej 509.63 euro për muaj si dhe nenit 35 par. 8 nënpar. 8.4, dhe nenit 35 par 9, të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017.

Prandaj, gjykata bazuar në nenit 35 par. 8 nënpar. 8.4 dhe nenit 35 par 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 vendosi për kompensimin e shumës së përgjithshme prej **2.293,33 euro (dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre euro, e tredhjetë e tre cent)**, dhe atë në emër të tri pagave përcjellëse shumë prej 1.528,89 euro dhe në emër të shpërblimit jubilar (150% një page bazë) shumë prej 764,44 euro.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë, gjykata nuk e aprovoi në lartësinë e cekur si në kërkesëpadi nga ana e te autorizuarit të paditësit, pasi që Gjkata lidhur me vendosjen u bazua në Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës nr.0113/2056, pasi që e njëjta është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe e rregullon këtë çështje në mënyrë specifike dhe se paditësi në pension ka dalur ( **10.01.2018**) në kohën kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.0113/2056 datës 18.04.2017, ndërsa sa i përket bazës në Kontratën Kolektive e Arsimit Parauniversitar 01B 2200 të datës 11.04.2014, me të cilën parashihet se “punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit të njihet e drejta në shpërblim jubilar në lartësia të tri pagave mujore të tij” gjykata nuk mund ta marrë për bazë këtë Kontratë për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nr..... datës 18.04.2017 e ka shfuqizuar Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar 01B 2200 të datës 11.04.2014, konkretisht nëni 48 i Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.0113/2056 datës 18.04.2017 ku është parapa se me hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate shfuqizohet Kontratën Kolektive të Arsimit Para universitar 01B 2200 të datës 11.04.2014.

Pa ashtu për sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë, gjykata nuk e aprovoi në lartësinë e precizuar nga ana e te autorizuarit të paditësit në seancën e datës 15.01.2019 pasi që Gjkata lidhur me vendosjen u bazua në Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, pasi që e njëjta është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe e rregullon këtë çështje në mënyrë specifike, ndërsa sa i përket bazës në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të datës 18.03.2014, me të cilën parashihet se “punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit të njihet e drejta në shpërblim jubilar në lartësia të tri pagave mujore të tij” gjykata nuk mund ta marrë për bazë Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive për faktin se nëse dy ligje e rregullojnë të njëjtën situatë, ligji që rregullon një çështje specifike (lex specialis) anashkalon ligjin që rregullon vetëm çështjet e përgjithshme (lex generalis), pra në rastin konkret duhet të aplikohet Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës e datës 18.04.2017 si ligj special.

Gjkata, me rastin e vendosjes si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, pati parasysh edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës të shprehura gjatë seancës gjyqësore, mirëpo të njëjtat pjesërisht i morri parasysh me rastin e aplikimit të Kontratës Kolektive, ashtu që e apliko Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës e datës 18.04.2017 si ligj special, ndërsa kundërshtimet e tjera nga i autorizuari i të paditurës, gjykata me arsyet e cekura me lartë, i refuzoi si të pabazuara, duke iu referuar provave në shkresat e lëndës.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për taks gjyqësore për padi në shumë prej 40 euro.

Gjkata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.107/2018 data 17.01.2019**

**GJYQTARI**  
***Naim Mehulli***

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.